

**FIRST INVESTMENT BANK
ALBANIA SH.A.**

**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më
31 Dhjetor 2009**

(me raportin e auditorëve të pavarur bashkëngjitur)



KPMG Albania Sh.p.k.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania
NIPT J91619001D

Telephone +355 4 2274 524
+355 4 2274 534
Telefax +355 4 2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raport i Audituesit të Pavarur

Tiranë, 30 Qershor 2010

Pronarëve të Banka e Parë e Investimeve - Shqipëri Sh.A.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të Banka e Parë e Investimeve - Shqipëri Sh.A. ("Banka") të cilat përbëhen nga bilanci kontabël në datë 31 Dhjetor 2009, dhe pasqyrat e të ardhurave, ndryshimet e kapitalit dhe të fluksit të parasë për vitin e mbyllur në atë datë si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në pajtim me "Metodologjinë e Raportimit Financiar" në përputhje me Nenin 47 i Ligjit për Bankat. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe ruajtjen e kontrollit të brendshëm, i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale, që mund të jenë pasojë e gabimeve apo mashtrimit; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave kontabël të duhura; dhe bërjen e çmuarjeve kontabël të cilat janë të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne t'u përmbahemi kërkesave etike të përshtatshme dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të fituar siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë që mbështet tepricat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura janë në varësi të gjykimit tonë, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, prej gabimit apo mashtrimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne shqyrtojmë kontrollin e brendshëm, i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por që nuk kanë për qëllim shprehjen e një opinionimi për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.



Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sigurtë për gjendjen financiare të Bankës me datë 31 Dhjetor 2009, për rezultatet e saj financiare dhe flukset e saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në pajtim me “Metodologjinë e Raportimit Financiar” në përputhje me Nenin 47 i Ligjit për Bankat.

KPMG Albania Shpk

KPMG Albania Sh.p.k.
“Dëshmorët e Kombit” Blvd.
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana
Albania

FIRST INVESTMENT BANK ALBANIA SH.A.

Bilanci Kontabël më 31 Dhjetor 2009

(në Lek '000)

	Shënime	31 Dhjetor 2009	31 Dhjetor 2008
Aktivet			
Arka dhe Banka Qendrore	5	422,450	425,357
Hua dhe paradhënie për bankat	6	382,191	147,446
Letra me vlerë të investuara	7	381,418	126,689
Letra me vlerë të blera dhe të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes	8	2,747,060	776,975
Hua dhe paradhënie për klientët	9	1,572,113	1,482,472
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	10	20,912	20,515
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	11	250,948	244,598
Aktive të tjera	12	88,465	90,311
Gjithsej aktivet		5,865,557	3,314,363
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	13	95,832	-
Detyrime ndaj klientëve	14	4,535,456	2,234,983
Provizione statistikore	9	20,934	17,424
Detyrime të tjera	15	21,646	9,109
Gjithsej detyrimet		4,673,868	2,261,516
Kapitali i aksionerëve			
Kapitali i paguar	16	1,304,792	1,174,632
Diferenca e rivlerësimit të kapitalit	16	140,281	(1,679)
Humbjet e mbartura		(120,106)	(67)
Humbja e vitit ushtrimor		(133,278)	(120,039)
		1,191,689	1,052,847
Gjithsej detyrimet dhe kapitali aksioner		5,865,557	3,314,363

Bilanci kontabël duhet të lexohet në përputhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare nga faqja 6 deri në faqen 30.

FIRST INVESTMENT BANK ALBANIA SH.A.

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009

(në Lek '000)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008
Të ardhura nga interesat	17	322,464	182,481
Shpenzime për interesat	18	(117,448)	(66,024)
Të ardhura nga interesat, neto		205,016	116,457
Te ardhura neto nga operacionet financiare	20	23,287	11,543
Të ardhura nga tarifa dhe komisione	19	28,864	23,231
Shpenzime për tarifa dhe komisione	19	(7,571)	(8,900)
Të ardhura nga tarifatat dhe komisionet, neto		21,293	14,331
Të ardhura/(shpenzime) të tjera, neto		167	(8)
Fitimi neto nga transaksionet e kursit të këmbimit		41,227	149,325
GJITHSEJ TE ARDHURA NGA VEPRIMTARIA BANKARE		290,990	291,648
Shpenzimet e personelit	21	(117,273)	(124,476)
Shpenzime administrative	22	(199,103)	(210,981)
Provizion për humbje nga kreditë	9	(44,307)	(33,981)
Amortizimi i aktiveve jo-materiale	10,11	(59,397)	(40,600)
Taksa të tjera përveç tatimit mbi fitimin		(2,486)	(1,649)
Të tjera		(1,702)	-
		(424,268)	(411,687)
Humbja para tatimit		(133,278)	(120,039)
Tatimi mbi fitimin	23	-	-
Humbja neto		(133,278)	(120,039)

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet në përputhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare nga faqja 6 deri në faqen 30.

FIRST INVESTMENT BANK ALBANIA SH.A.

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009

(në Lek '000)

	Shënime	2009	2008
Flukset e parasë nga aktivitetet operacionale			
Humbja neto për periudhën		(133,278)	(120,039)
Rregullime për kuadrinin e ndryshimeve të aktiveve neto e paraqitur nga aktivitetet operacionale:			
(Rritje) në rezervat e detyrueshme		(94,010)	(103,753)
Ulje në interesa për tu arkëtuar		3,234	15,788
(Rënie)/ritje në interesa për tu paguar		(2,175)	17,038
Fond rezervë		86,689	42,371
Transferim nga fondet rezervë		(40,680)	(8,390)
Amortizimi		59,397	40,600
Humbja nga nxjerrja jashtë përdorimit e mjeteve të qëndrueshme		3,638	-
Efekti i zërave të tjerë të përlogaritur dhe të shtyrë		2,324	1,257
Ndryshimi në diferencat e rivlerësimit		141,960	18,999
		<hr/>	<hr/>
Flukset e parasë para lëvizjes në kapitalin qarkullues		27,099	(96,129)
Ndryshimi në bonot e thesarit dhe bono të tjera të përshtatëshme për refinancim me bankën qendrore		(270,000)	(40,000)
Ndryshimi në huatë për bankat dhe institucionet e kreditit		(234,757)	797,516
Ndryshimi në huatë dhe paradhëniet për klientët		(121,646)	(955,055)
Ndryshimi në mjetet e tjera		2,860	(39,963)
Ndryshimi në detyrimin ndaj bankave dhe institucioneve të kreditit		95,810	-
Ndryshimi në detyrimin ndaj klientëve		2,302,670	1,217,495
Ndryshimi në detyrimet e tjera		7,497	(4,694)
		<hr/>	<hr/>
Flukset e parase nga aktivitetet operacionale		1,809,533	879,170
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e letrave me vlerë të investimit		(1,966,828)	(775,988)
Blerje të mjeteve të qëndrueshme		(69,782)	(60,220)
		<hr/>	<hr/>
Flukset e parasë të përdorura për aktivitetet investuese, neto		(2,036,610)	(836,208)

FIRST INVESTMENT BANK ALBANIA SH.A.

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009
(vazhdim)

(në Lek '000)

	Notes	2009	2008
Flukset e parasë nga aktivitetet financuase			
Rritja e kapitalit të paguar		<u>130,160</u>	<u>121,920</u>
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese, neto		130,160	121,920
(Rënia)/rritja neto e parasë gjate vitit		(96,917)	164,882
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të periudhës		<u>226,631</u>	<u>61,749</u>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të periudhës		<u>129,714</u>	<u>226,631</u>

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare duhet të lexohet në përputhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare nga faqja 6 deri në faqen 30.

FIRST INVESTMENT BANK ALBANIA SH.A.

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009

(në Lek '000)

	Kapitali i paguar	Diferenca e rivlerësimit të kapitalit	Humbja e mbartur	Gjithsej
Balanca më 31 Dhjetor 2007	1,052,712	(20,678)	(67)	1,031,967
Diferenca e rivlerësimit të kapitalit	-	18,999	-	18,999
Shtimi i kapitalit të paguar	121,920	-	-	121,920
Humbja neto e vitit	-	-	(120,039)	(120,039)
Balanca më 31 Dhjetor 2008	1,174,632	(1,679)	(120,106)	1,052,847
Diferenca e rivlerësimit të kapitalit	-	141,960	-	141,960
Shtimi i kapitalit të paguar	130,160	-	-	130,160
Humbja neto e vitit	-	-	(133,278)	(133,278)
Balanca më 31 Dhjetor 2009	1,304,792	140,281	(253,384)	1,191,689

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit duhet të lexohet në përputhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare nga faqja 6 derin në faqen 30.
Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtorët e First Investment Bank, Albania Sh.a. më 30 Qershor 2010 dhe janë firmosur nga:

Bozhidar Ilodrov
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Edvin Lako
Drejtor Finance

Ardian Kamberi
Drejtor Ekzekutiv

FIRST INVESTMENT BANK ALBANIA SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009

(shumat në Lek'000, nëse nuk thuhet ndryshe)

1. Njësia ekonomike raportuese

First Investment Bank - Albania (Banka) e cila ushtron veprimtarinë e saj në Republikën e Shqipërisë është një shoqëri aksionere e themeluar në më 1 Gusht 2005 dhe e ka zyrën e regjistrimit në Tiranë, Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 14.

Banka ka marrë një licensë për të ushtruar aktivitetin bankar më 6 Korrik 2007 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë (BSH) në përputhje me të cilën i është dhënë mundësia të kryej të gjitha transaksionet bankare të lejuara nga Legjislacioni Shqiptar. Banka është kryesisht e përfshirë në aktivitetet bankare për korporatat dhe shitjet me pakicë. Data e regjistrimit të aksioneve të kapitalit është 6 Qershor 2007 (më pas i referohemi si "Data e Rregjistrimit") dhe ishte në shumën 8,474,559 Euro. Banka është një filial i First Investment Bank A.D. (më pas i referohemi si "Mëma"), një njësi ekonomike e themeluar në Bullgari si institucion financiar e cila zotëron 99.99% të aksioneve të Bankës. Banka mori licensë të plotë bankare më 26 Qershor 2007 dhe e filloi aktivitetin bankar si një njësi e re ekonomike më 1 Shtator 2007. Struktura e aksionerëve të shoqërisë mëmë më 31 Dhjetor 2009 është si më poshtë :

Aksionerët	% e aksioneve
Z. Ivailo Dimitrov Mutafchiev	28.94
Z. Tzeko Todorov Minev	28.94
Legnano Enterprise Limited Cyprus	7.68
Domenico Ventures Limited, British Virgin Islands	9.72
Rafaela Consultants Limited, British Virgin Islands	9.72
Aksionerë të tjerë (aksionerë të cilët zotërojnë aksione nga tregtimi në bursë – Sofie)	15.00
Gjithsej	100.00

Banka mori aktivitetin, aktivitet and detyrimet, të drejtat dhe detyrimet nga First Investment Bank – Dega e Tiranës ("Dega"), e cila ushtronte veprimtarinë e saj si degë e huaj e Mëmës në Shqipëri që nga Shkurti 1999. Marrja e aktivitetit u bazua në një marrëveshje transferuese (më pas i referohemi si Marrëveshja Transferuese) midis palëve më datë 6 Nëntor 2006, e formuluar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë. Marrëveshja parashikonte transferimin e aktiveve dhe detyrimeve ma vlerën kontabël më 31 Gusht 2007. Fillimi i veprimtarisë bankare për Bankën përkoi me hyrjen në fuqi të transferimit të aktiveve dhe detyrimeve. Pasoja ligjore e këtij transferimi për Degën ishte revokimi i licensës bankare dhe fillimi i procedurave të likuidimit në përputhje me ligjin Shqiptar. Më 9 Shtator 2007 dhe 14 Shtator 2007 dy ndryshime respektive për Marrëveshjen e Transferimit u firmosën ku të dyja palët ranë dakort që në bazë të transferimit të aktivitetit një e drejtë lindi për Bankën në shumën 143,502,561 Lek ose 1,161,588 Euro. Të dyja palët ranë dakort që Dega duhet të paguajë Bankës këtë shumë përpara 30 Nëntorit 2007.

FIRST INVESTMENT BANK ALBANIA SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009

(shumat në Lek'000, nëse nuk thuhet ndryshe)

1. Njësia ekonomike raportuese (vazhdim)

Aktivitetet për të cilat u ra dakort të transferoheshin ishin si vijon:

- të gjitha kontratat e kredive me klientët;
- të gjitha kontratat e llogarive rrjedhëse me klientët;
- të gjitha kontratat e depozitave me klientët;
- të gjitha kontratat e qerave;
- të gjithë kontratat e punësimit duke garantuar që nuk ka ndonjë konflikt ligjor;
- të gjithë aktivet afatgjata të cilat kanë vlerë monetare;
- të gjithë aktivet financiare, emrin e mirë dhe cdo aktiv të qëndrueshëm të patrupëzuara dhe të drejta të cilat ishin gjeneruar nga aktiviteti i Degës.

2. Deklerata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me “Metodologjinë e Raportimit Financiar ose MRF” të aprovuara nga Këshilli Mbikqyres i Bankës së Shqipërisë më 24 Dhjetor 2008. MRF u aprovuan për qëllime rregullative, në përputhje me Nenin 47 i Ligjit Nr. 9662, më datë 18 Dhjetor 2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

(a) Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Bankës, shumat janë të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt. Sikurse lejohet edhe nga legjislacioni local, kapitali i paguar është regjistruar në Euro në përputhje me kurset e këmbimit historike në datën e transaksionit, dhe është paraqitur në Lek si ekuivalent i balancës origjinale të Euros. Në përputhje me rregulloret lokale, diferenca midis vlerës në Lek të kapitalit me kursin e këmbimit historik dhe kursit të këmbimit në datën e bilancit regjistrohet si rezervë nga kursi i këmbimit në capital.

Pasqyrat financiare janë përgatitur me kosto historike dhe politikat kontabël të aplikuara janë të njëjta me ato të aplikuara nga Banka për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008.

(b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj, të cilat janë me kosto historike këmbehen me kursin e këmbimit të fund-vitit. Diferencat që lindin nga kursi i këmbimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, të cilat janë me kosto historike, këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Për më tepër, zbritja për humbjet nga kreditë, provizioni për garancitë e klientëve dhe fondet speciale të zgjeruara nga aksionerët, të gjitha në monedhë të huaj këmbehen me kursin e këmbimit në datën e raportimit.

FIRST INVESTMENT BANK ALBANIA SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009

(shumat në Lek'000, nëse nuk thuhet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(b) Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Kursi i këmbimit i aplikueshëm (Lek me njësinë e monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 Dhjetor 2009 dhe 31 Dhjetor 2008 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2009	31 Dhjetor 2008
USD	95.81	87.91
EUR	137.96	123.8
GBP	154.64	127.66
CHF	93.04	82.97

(c) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përbëhen nga balancat në arkë dhe balancat e pakushtëzuara me Bankën Qëndrore. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalente me to sipas përkufizimit të mësipërm dhe aktivet me likuiditet shumë të lartë dhe me maturitet më pak se tre muaj, të cilat janë subjekt i rreziqeve jo të rëndësishme nga ndryshimi në vlerën e drejtë, dhe përdoren nga banka për menaxhimin e detyrimeve afat-shkurtra.

(d) Letra me vlerë të investuara të mbajtura deri në maturitet

Letrat me vlerë të investuara të cilat kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet fikse të cilat Banka ka qëllimin pozitiv dhe mundësinë për ti mbajtur deri në maturitet përfshijnë bonot e thesarit dhe obligacionet qeveritare. Pas njohjes fillestare, letrat me vlerë të investuara mbarten me koston e amortizuar.

(e) Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve

Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve raportohen me vlerën bruto. Një provision për humbjet potenciale nga kreditë rregjistrohet si detyrim në bilancin kontabël të Bankës.

Politikat e kredidhënies dhe procedurat e Bankës janë në përputhje me instruksionet e Bankës së Shqipërisë (Regullorë No. 52 amenduar më 10 Qershor 2009). Banka i klasifikon kreditë sipas kategorive të mëposhtme duke adoptuar normat e mëposhtme të provizionit për humbjet nga kreditë:

Lloji i kredisë	Provizioni i humbjes	Ditët e vonesave
Standarde	1%	Deri në 30 ditë
Në ndjekje	5%	31 deri në 90 ditë
Nën-standarde	20%	91 deri në 180 ditë
Të dyshimta	50%	181 deri në 365 ditë
Të humbura	100%	mbi 365 ditë

Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve raportohen neto nga provizioni për humbjet specifike nga kreditë për kreditë e klasifikuara si nën-standarde, të dyshimta dhe të humbura. Provizionet e krijuara për humbje të mundshme për kreditë e klasifikuara si standarde dhe në ndjekje janë klasifikuar si provision statistikor në pasiv të bilancit kontabël.

Provizioni për humbjet nga kreditë

Provizioni është rregjistruar si kundër aktiv ndaj kredive të klientëve në bilancin kontabël. Ky provision përfshin llogaritje të cilat mbulojnë humbjet e mundshme nga kreditë nën-standarde, të dyshimta dhe të humbura.

FIRST INVESTMENT BANK ALBANIA SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009

(shumat në Lek'000, nëse nuk thuhet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(e) Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve (vazhdim)

Provizioni për rreziqet dhe shpenzimet (vazhdim)

Provizioni për rrezikun statistikor për kreditë dhe garancitë është i bazuar në informacion statistikor të lidhura me humbjet nga kreditë nga kreditë standarte dhe në ndjekje.

(f) Pajisjet dhe aktivet jo-materiale

Pasuria dhe pajisjet njihen me kosto minus amortizimin e akumuluar, të cilat janë llogaritur me metodën zbritëse, përveç amortizimit të pasurisë i cili është i bazuar në metodën lineare. Aktivet jo-materiale janë amortizuar me metodën lineare. Normat vjetore të amortizimit janë si më poshtë:

Përmirësimet në qeramartje	25-20 %
Instalimet	10 %
Mjetet Motorike	20-10%
Paisje zyre dhe elektronike	10%
Paisje kompjuterike	20%
Paisje zyre dhe te tjera	10%
Të tjera	10%

(g) Aktivet jo-materiale

Aktivitet jo-materiale përbëhen nga licensat dhe programet kompjuterike, të cilat janë njohur në kosto minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi është llogaritur me bazë lineare.

Licensat	25-20 %
Programet kompjuterike dhe të tjera	10%

(h) Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, të tjera nga të ardhurat nga interesi nga kreditë nën-standarde, të dyshimta dhe të humbura, të cilat njihen në bazë të mjeteve monetare.

(i) Komisionet

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet lindin nga shërbimet financiare të Bankës dhe njihen kur shërbimi respektiv është kryer.

(j) Tatimi

Banka përcakton tatimin në fund të periudhës në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Të ardhurat e tatueshme janë llogaritur duke rregulluar fitimin statutor përpara tatimit për disa të ardhura dhe shpenzime sic kërkohet nga ligji Shqiptar.

(k) Kompensimi

Kontratat për monedhat e huaja janë marrëveshje për këmbimin e shumave specifike me një kurs këmbimi specifik, me kurs këmbimi të castit ose datë të përcaktuar. Shuma e këtyre kontratave nuk paraqet tregun aktual ose rrezikun e kredisë që lidhet me këtë produkt.

FIRST INVESTMENT BANK ALBANIA SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009

(shumat në Lek'000, nëse nuk thuhet ndryshe)

4. Informacione shpjeguese për menaxhimin e rreziqeve

Më poshtë paraqiten rreziqet e ndryshme ndaj të cilave Banka është e ekspozuar ndaj instrumentave financiarë dhe përjasja për menaxhimin e këtyre rreziqeve.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit lind në financimet e përgjithshme të aktiviteteve të Bankës dhe në menaxhimin e pozicionimit. Ai përfshin si rrezikun e paaftësisë për të financuar aktivet me maturitet dhe norma të përshtatëshme ashtu edhe rrezikun e paaftësisë për të likuiduar një aktiv me një cmim dhe brenda një afati kohor të arsyeshëm për të përmbushur detyrimet.

Fondet krijohen duke përdorur një sërë instrumentash duke përfshirë depozitat dhe kapitalin e paguar. Kjo rrit fleksibilitetin e fondeve, kufizon varësinë nga një burim i vetëm financimesh dhe përgjithsisht ul koston e fondeve. Banka përpiket për të ruajtur balancën midis vazhdimësisë së fondeve dhe fleksibilitetit nëpërmjet përdorimit të detyrimeve me maturitete të shpërndara në kohë. Banka vazhdimisht vlerëson rrezikun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshimet e duhura në financime, në përputhje me qëllimet dhe objektivat e vendosura në startegjinë e Bankës.

Më 31 Dhjetor 2009 tridhjetë depozituesit jo-financiarë më të mëdhenj përbëjnë 40% (2008: 41 %) të totalit të depozitave nga klientët.

Rreziku i normës së interesit

Banka e vlerëson rrezikun e normës së interesit si risku që të ardhurat nga interesi i gjeneruar nga aktivet që mbartin interesa mund të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve të papritura të normave të interesit në treg. Veprimtaritë e Bankës janë subjekt i rrezikut të luhatjeve të normës së interesit në atë nivel që aktivet që fitojnë interes dhe detyrimet që paguajnë interes maturohen ose ricmohen në kohë të ndryshme ose shuma të ndryshme. Në rastin e normave të ndryshueshme të aktiveve dhe detyrimeve Banka është gjithashtu e ekspozuar ndaj rrezikut bazë i cili është diferenca në karakteristikat e ricimit të treguesve me norma të nryshueshme, sic janë normat e repove të Bankës së Shqipërisë, LIBOR dhe EURIBOR, megjithëse këto tregues tentojnë të lëvizin në një lidhje të fortë. Vec kësaj, efekti aktual varet nga një numër faktorësh të tjerë, duke përfshirë nivelin e shlyerjeve që bëhen më përpara ose më vonë sesa data e kontraktuar dhe ndryshimet në normat e interesave brenda periudhës së ricimit dhe ndërmjet monedhave.

Në mënyrë që të masë riskun nga interesat të aktiviteteve jo-tregtare, Banka e mat impaktin që ka një ndryshim në normat e tregut në të ardhurat neto nga interesat.

Rreziku i monedhës

Rreziku i monedhës është rreziku që ka të bëjë me luhatjen e vlerës së drejtë ose flukset e ardhëshme të parasë të një instrumenti financiar nga ndryshimet në normën e kursit të këmbimit. Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të monedhës nëpërmjet transaksioneve në monedhë të huaj dhe emërtimi i instrumentave financiarë në monedhë të huaj.

Nga ekspozimi i transaksioneve të Bankës lindin fitime ose humbje nga këmbimet në monedha të huaja të cilat njihen në humbje ose fitim. Këto ekspozime përfshijnë aktivet dhe detyrimet monetare të Bankës të cilat nuk janë në monedhën raportuese së Bankës.

Në lidhje me aktivet dhe detyrimet financiare monetare në monedhë të huaj të cilat nuk janë ekonomikisht të mbrojtura (hedged), Banka e menaxhon rrezikun e monedhave të huaja në përputhje me politikat që vendosin kufizime në pozicionimin e monedhës dhe marrëveshjeve.

FIRST INVESTMENT BANK ALBANIA SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009

(shumat në Lek'000, nëse nuk thuhet ndryshe)

4. Informacione shpjeguese për menaxhimin e rreziqeve (vazhdim)

Rreziku i kredisë

Banka është subjekt i rrezikut të kredisë nëpërmjet aktivitetit huadhënës dhe në ato raste kur ajo vepron si ndërmjetëse për llogari të klientëve të saj ose palëve të treta ose jep garanci. Në lidhje me këtë, rreziku i kredisë për Bankën lind nga mundësia që palë të ndryshme mund të mos përmbushin detyrimet e tyre kontraktuale. Menaxhimi i ekspozimit të rrezikut të kredisë ndaj huamarrësve bëhet nëpërmjet analizave të rregullta të aftësisë pagueuse të huamarrësve dhe përcaktimi i një note klasifikuese. Gjithashtu ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë menaxhohet pjesërisht duke marrë kolaterale dhe garanci. Vec kësaj, Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë për zërat jashtë bilanci nëpërmjet angazhimeve deri në nivelin e kredive dhe garancive të dhëna (shiko shënimi 28).

Përqëndrimi i rrezikut të kredisë (brenda ose jashtë zërave të bilancit) që lind nga instrumentat financiarë ekziston për palë të tjera kur ato kanë karakteristika të njëjta ekonomike të cilat mund të bëjnë që aftësia e tyre për të përmbushur detyrimet kontraktuale të ndikohet njësoj nga ndryshime në kushtet ekonomike ose faktorë të tjerë. Përqëndrimi kryesor i rrezikut të kredisë lind nga lloje të ndryshme klientësh dhe vendodhja e tyre në lidhje me investimet e Bankës, huatë dhe paradhëniet, detyrimet e ardhëshme të angazhimeve në nivelin e kredisë dhe garancive të dhëna..

Politika e Bankës është që të kërkojë kolateral të përshtatshëm nga klientë të sigurt përpara disbursimit të kredisë. Garancitë dhe letrat e kreditit janë gjithashtu subjekt i një vlerësimi strikt përpara se të aprovohen. Marrëveshjet specifikojnë limite monetare të detyrimeve të Bankës. Niveli i kolateralit i mbajtur për garancitë dhe letrat e kreditit është të paktën 100 përqind.

Kolaterali për kreditë, garancitë dhe letrat e kreditit është zakonisht në formë monetare, inventar hipotekor, investime të regjistruara ose pasuri të tjera.

Administrimi i kapitalit

Kapitali rregullator

Rregullatori i Bankës, Banka e Shqipërisë, vendos dhe monitoron kërkesat në lidhje me kapitalin rregullator. Në implementimin e kërkesave aktuale për kapitalin rregullator, Banka është e detyruar të mbajë në jo më pak se 12% raportin e totalit të kapitalit mbi aktivet e e ponderuara me normat riskut. Normat e riskut të përdorura për ponderimin e aktiveve përcaktohen në përputhje me kërkesat specifike të cilat kanë për qëllim të reflektojnë nivelet e ndryshme të riskut që mbartin aktivet dhe zërat jashtë bilancit.

Banka i llogarit kërkesat për ekspozimin e saj ndaj riskut të kredisë duke u bazuar në rregulloren e Bankës së Shqipërisë mbi mjaftueshmërinë e kapitalit. Ekspozimet merren në konsideratë duke përdorur shumat e tyre në datën e bilancit. Zërat jashtë bilancit të lidhura me angazhimet llogariten duke aplikuar kategori të ndryshme të faktorëve të konvertimit, të dizenuara për të konvertuar këto zëra në ekuivalentë të bilancit. Shumat e rezultuara ekuivalente ponderohen për riskun duke përdorur përqindje të ndryshme (0%, 20%, 50%, 100%, dhe 150%) në varësi të klasave të ekspozuara. Metoda të ndryshme janë përdorur për të zvogëluar riskun si për shembull transaksione me kolateral dhe garanci. Kapitali rregullator i Bankës analizohet në dy kategori:

- Kategorial e kapitalit (kapitali bazë), i cili përfshin kapitalin e aksioneve të zakonshme, primet e aksioneve, rezervat statutorë, rezerva të tjera të përgjithshme, fitimi i akumuluar nga vitet e mëparëshme dhe interesi i pakicës pas zbritjes së emrit të mirë, aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara dhe humbjet e porealizuara nga investimet e vlefshme për shitje.

FIRST INVESTMENT BANK ALBANIA SH.A.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009

(shumat në Lek'000, nëse nuk thuhet ndryshe)

4. Informacione shpjeguese për menaxhimin e rreziqeve (vazhdim)

Rreziku i kredisë (vazhdim)

- Kategoria 2 e kapitalit (kapitali plotësues), i cili përfshin borxhin e varur të kualifikuar, përkatësisht borxhin e vazhdueshëm si dhe borxhin e varur.

Kufizimet e mëposhtëme aplikohen tek elementët e kapitalit bazë: Kategoria 2 e kapitalit nuk mund të jetë më e madhe se kategoria 1 e kapitalit dhe kapitali i huave të varura të kualifikuara nuk mund të jetë më i madh se 50% e kategorisë 1 të kapitalit. Politika e Bankës është që të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë të investuesit, kreditorët si dhe në treg dhe të mbështesë zhvillimin e biznesit në të ardhmen. Impakti i nivelit të kapitalit në të ardhurat e aksionerëve është i njohur dhe Banka e pranon nevojën për të mbajtur një balancë midis mundësisë për më shumë të ardhura dhe avantazheve dhe sigurisë të qe vinë nga një pozicion i qëndrueshëm kapitalit.

